

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE
FINANCIARE PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2006

“Audit & Conto”
UÇK 2a, Prishtinë

12.03.2007



Përmbajtja:

RAPORT I AUDITOREVE TE PAVARUR.....	3
II. Hyrje-Historiku.....	4
III. Fushëveprimi- Objektivat dhe shtrirja e auditimit.....	6
IV. Njohja dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe i sistemit të kontabilitetit,.....	7
1. Zbatimi i Ligjshmërisë; Ligji nr. 2002/7 për telekomunikacion	8
2.Funksionimi i Bordit te ART-es.....	8
3. Menaxhimi i te hyrave dhe shpenzimeve financiare.....	9
4. Raportimi Fianciar/ korniza e raportimeve	10
5. Kontabiliteti.....	11
6. Prokurimi.....	12
7. Personeli/marrëdhënia e punës	12
8. Pety Keshi.....	13
9.Asetet/pasurit	14
Regjistrimi i pasurive më 31.12.2006 eshte i perfunduar	14
VIII. Pasqyrat Financiare	16
Tabela 1. Neni 7 – Gjendja e parasë së gatshme.....	16
Tabela 2. Neni 8 – Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të organizatave	17
Tabela 3. Neni 9 – Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit.....	18
Tabela 4. Neni 10 – Pasqyra e ndërrimeve të buxhetit	18
Tabela 5. Neni 11 – Pasqyra e të hyrave të arkëtuara – organizatat qendrore.....	18
Tabela 6. Neni 14 – Pasqyra e faturave të papaguara (obligimeve).....	19
XIII. SHËNIME SQARUESE	21
XIV. Lista e dokumentacionit të konsultuar dhe të audituar	27
XV. Kontaktimi me zyrtarët përgjegjës gjatë procesit të Auditimit.....	28
XVI. Sqarime të shkurtesave të përdorura :.....	28

RAPORT I AUDITOREVE TE PAVARUR

MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TE AUTORITETIT RREGULLATIV TE TELEKOMUNIKACIONIT TE KOSOVËS PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 Dhjetor 2006

Bordit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit Prishtinë

Ne kemi audituar bilancin kontabël bashkëlidhur të ART për periudhën 1 Janar 2006 deri 31 Dhjetor 2006, pasqyrat përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë date.

Përgatitja e deklarimeve financiare është përgjegjësia Menaxhmentit të ART-ës përgjegjësia e jonë është të shprehim një opinion për to, bazuar në shqyrtimet dhe ekzaminimet e kryera.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit . Këto standarde auditimi kërkojnë që auditimi të planifikohet dhe të zbatohet procedura auditimi për të dhënë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin ekzaminimin, mbi bazën e testimeve, të dokumenteve që mbështesin shifrat dhe informacionet e tjera në pasqyrat financiare.

Auditimi përfshin gjithashtu edhe vlerësimin për parimet e kontabilitetit të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin për paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se auditimet e kryera nga ne sigurojnë një bazë të arsyeshme për opinionin e dhënë.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të ART-ës me datën 31 Dhjetor 2006, dhe rezultatin e veprimtarisë për ushtrimin e mbyllur në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

“AUDIT & CONTO” sh.p.k.

Auditor

Ruga UÇK B1/32 Prishtinë
Tel :038 247724 mob 044 506 702

Prishtinë, më 12.03.2007



II. Hyrje-Historiku

Në bazë të kontratës të datës 10.02.2007, ne kemi marrë përsipër të kryejmë auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për Kosovë, zyra në Prishtinë, për vitin që përfundon më 31.12.2006.

Në harmoni me termat e referimit të cilët janë caktuar në Kontratën e datës 10.02.2007, ne kemi përfunduar këtë auditim.

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit është themeluar në vitin 2003 sipas Rregullores së UNMIK 2003/16 si autoritet i pavarur dhe jo-profitabil. ART zbaton politikat e IPVQ së dhe Ministrisë , gjithmonë në pajtim me këtë ligj si dhe në pajtim me të gjitha Urdhëresat Administrative dhe rregulloret të nxjerra për implementimin e këtij ligji.

Autoriteti i Rregullator i Telekomunikacionit është përgjegjës për licencimin , rregullimin dhe menaxhimin e ofruesve të shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë; inkurajimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe konkurrencën lojale në përputhje me dispozitat në fuqi, rregullimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve të këtyre shërbimeve .

ART, i themeluar nga ky ligj, si një trup i pavarur përbrenda IPVQ, mban përgjegjësinë për implementimin e politikave të IPVQ dhe Ministrisë, të udhëhequra nga ky ligj si dhe të gjitha pjesët legjislative të nxjerra në pajtim me këtë ligj.

ART-ja ka kompetencat për nxjerrjen e rregullave administrative dhe udhëzime për implementimin e këtij ligji.

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ka financuar themelimin e ART-it dhe vitin e parë të veprimtarisë së tij. Ministria ka propozuar dhe Kuvendi ka miratuar shumën e buxhetit fillestarë të ART-it dhe ka ndarë fonde të mjaftueshme nga BKK. Më tutje, ART-i është i vetë-financuar, duke mbuluar shpenzimet e arsyeshme dhe përkrahjen adekuate administrative dhe teknike, shumë kjo e cila nuk do të jetë më e vogël se shuma e ndarë vitin paraprak, përveç nëse kuvendi vendos ndryshe.

ART, realizon të hyra të cilat mblidhen përmes aplikimit të tarifave rregullative, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- (a) autorizimet;
- (b) liçensimet;
- (c) dhënie e numrave, dhe
- (d) akordimin e të drejtës për përdorim të spektrit frekuencor.

Të gjitha fondet e mblidhura nga ART-i, do të depozitohen në një llogari të krijuar enkas për përdorimin e tij në Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës(BPK).

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit , Prishtinë
Raport i Auditimit të Pasqyrave Financiare, për vitin që përfundon më 31.12.2006

ART-i do të përdorë standarde të kontabilitetit për të gjitha llogaritë e saja në pajtim me ligjet e Kosovës. Teprica e krijuar nga taksat, licencimet dhe autorizimet që e kalojnë shumën e buxhetit të miratuar nga Kuvendi për ART-n, do të derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

ART-i do të emërojë një auditor të kualifikuar të jashtëm, që të bëjë revizionimin e llogarive të tij në pajtim me ligjet e Kosovës.

ART-i do të dorëzojë buxhetin për shqyrtim apo miratim Kuvendit, jo më pak se 2 muaj para fillimit të secilit vit fiskal.

Jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së secilit vit fiskal, ART-i do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Kuvendit një raport vjetor që përmban detaje financiare, që i përkasin aktiviteteve të ART-it për vitin paraprak. Një version elektronik i atij raporti, do të publikohet në faqen zyrtare të ART-it në internet.

Autoriteti ligjor i ART-it, do të mbesë në bordin e ART-ës. Vendimet e bordit do të merren në mënyrë transparente, të pavarura nga ndikimet politike, industriale apo nga ndikimet tjera.

Bordi do të përbëhet nga pesë (5) anëtar.

Anëtarët e bordit rregullator, me rekomandim të Ministrisë së Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit, i propozon Qeveria dhe do të emërohen nga Kuvendi.

Anëtarët e Bordit Rregullativ do të paguhën në pajtim me skemën aplikative të pagave për anëtarët e Kuvendit, e cila do të pasqyrohet në buxhetin fillestar të ART-it dhe do t'i prezantohet Kuvendit për miratim.

Ministri i Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit në konsultim me Kryeministrin, do të emërojë një anëtarë të bordit që të jetë kryesuesi i atij bordi. Kryesuesi, do të udhëheqë takimet dhe aktivitetet e bordit, do të merr përgjegjësinë për administrimin e ART-it, si dhe do të mbikëqyrë zgjedhjen, punësimin, përfundimin

e kontratave si dhe administrimin e përgjithshëm të punësuarve.

Secili anëtar i bordit rregullator do të shërbejë me një mandat prej 5 vitesh nga data e emërimit të tij..

III. Fushëveprimi- Objektivat dhe shtrirja e auditimit

Ne kemi përformuar auditimin në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit /SNA . Standardet e përmendura kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të ekzekutojmë auditimin në mënyrë që të nxirret një siguri e arsyeshme se gjendjet e prezantuara në Pasqyrat Financiare, për periudhën kalendarike 01 .01.2006 deri më 31 dhjetor 2006, japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare të ART-es, si dhe Pasqyrat Financiare të ART janë në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP), me "Raportin Financiar Kontabilitetin sipas kesh-it" dhe kornizën mbi raportimet financiare vjetore, të Organizatave Buxhetore- Udhëzimi Administrativ 2005/15 dhe 2006/14 mbi përmbajtjen e Pasqyrave Financiare të Organizatave Buxhetore.

Të ofrojmë një opinion profesional për pasqyrat financiare të ART për vitin e përfunduar me 31.12. 2005.

Se përdorimi i të gjitha fondeve dhe burimeve nga ART-ja të është bërë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe procedurat e aplikueshme në Kosovë, duke u përqendruar vëmendjen sidomos efikasitetit dhe efektivitetit, dhe se fondet dhe burimet janë përdorur vetëm për destinimet për të cilat janë caktuar. Auditimi ynë përmban hulumtimin e informatave të mbledhura të rëndomta për të vërtetuar shumat dhe saktësitë e transaksioneve financiare

Të verifikojmë se procedurat që zbatohen nga ART-ja janë në harmoni me Politikat dhe procedurat e përcaktuara nga MEF-i dhe Thesari, si dhe të vlerësojmë se sa janë efektive procedurat e kontrollit të brendshëm.

Objektivi kryesor i këtij Auditimi është të mundësohet Auditorit të jap një opinion nëse pasqyrat financiare të vitit 2006 japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për të hyrat e mbledhura dhe për shpenzimet e bëra gjatë vitit 2006 dhe nëse këto pasqyra janë të përgatitura në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik ("SNKSP") për sa i takon "Raportimit Financiar mbi Bazat e Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". SNKSP janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve ("FNK").

Si dhe nëse Pasqyrat Financiare janë të përgatitura në harmoni me kornizën raportuese UA 2006/14 dhe 2006/15 të MEF-it.

Objektivë e auditimit do jetë që të mundësojë auditorin ta shprehë opinionin se a janë zbatuar ligji për krijimin e të hyrave dhe sa janë aplikuar ligjet gjatë shpenzimit të parave publike dhe se shërbimet e ofruara janë në përputhshmëri me kornizën ligjore në Kosovë në metodën më ekonomike, efektive dhe efikase.

Ne, po ashtu, jemi siguruar se:

- Kontot për prezantimin e llogarive janë në harmoni me shumat e prezantuara dhe të regjistruara.

- Shumat janë shpenzuar për situatat të cilat janë specifikuar.
- Auditimi është kryer në harmoni me rregullat e kërkuara në instruksionet e auditimit lidhur me kryerjen e detyrave të auditimit në lidhje me Auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencive Buxhetore.
- Se a janë pasuritë në funksion të entitetit.
- Politikat e kontabilitetit janë apo nuk janë konsistente prej vitit në vit.
- Politika e amortizimit është në harmoni me SKK dhe Rregulloret e Administratës Tatimore.
- Janë të përfshira të gjitha të hyrat e realizuara, përfshirë edhe fondet e donatorëve apo grantet qeveritare.
- Përmbledhjen e shpenzimeve të treguar nën titujt kryesorë të Pasqyrës dhe me kategoritë kryesore të shpenzimeve, për vitin fiskal 2006.
- Bilancin që tregon pasuritë - sipas Udhëzimit Administrativ 2005/11
- Regjistrimi i Pasurive më 31.12.2006 sipas Udhëzimit Administrativ 2005/11
- Respektimi i procedurave të parapara me Ligjin 2003/17 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Udhëzimet e tjera Administrative
- Komente mbi saktësinë, efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve të ushtruara sipas procedurave të aplikueshme financiare,

IV. Njohja dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe i sistemit të kontabilitetit,

- Kemi zgjedhur strategjinë e mosbesimit (apo të testeve të pavarura) në kontrollin e brendshëm. Kemi bërë biseda me nivelin e duhur të menaxhmentit, mbikëqyrësve dhe personelit tjetër. Këtu hyjnë inspektimi i dokumentacionit, raporteve dhe i dosjeve elektronike.
- Gjatë procedurave audituese, në bazë të asaj që kemi arritur të shohim, mund të konstatojmë se këtu kontrollohen të gjitha raportet ditore , mujore dhe dokumentet e tjera financiare nga disa nivele.
- ART nuk ka të angazhuar auditor të brendshëm e as departament të auditimit por aplikon sistem të kontrollit përmes politikave dhe procedurave të rregullta
- Në fushën e kontabilitetit, ART ka një program FREE BALANCE, i përgatitur nga Thesari, nga i cili në çdo kohë mund të nxirren informata të nevojshme vetëm mbi bazën e keshit, pra vendimmarrja mund të bazohet në të dhënat që gjenerohen nga FREE BALANCE, por vetëm mbi bazën e inkasimit dhe pagesave e jo edhe mbi bazën akruale.
- Dokumentacioni është mirë i arkivuar, i klasifikuar dhe i kompletuar.
- I gjithë personeli ka treguar një kooperativitet të lartë dhe gatishmëri të punojë nën presion dhe në kushte të tensionuara.

1. Zbatimi i Ligjshmërisë; Ligji nr. 2002/7 për telekomunikacion

- Funksionimi konform Ligjit në tërë territorin e Kosovës nuk është duke u bere ngase ka pengesa objektive te cilat ia pamundësojnë kontrollimin ne ter territorin e Kosovës
- Ka pengesa ne realizimin e te hyrave/te ardhurave vetjake nga dy aspekte:
 1. Së pari PTK-ja si kompani e vetme në Kosovë e kësaj natyre nuk është e gatshme te paguaj tërë shumen e dakorduar, ngase ART nuk ka qen në gjendje të mbikëqyr tërë territorin e Kosovës
 2. Së dyti ka pas kompani ilegale te cilat kanë operuar ne territorin e Kosovës dhe te cilat nuk ju kanë nënshtruar këtij Autoriteti dhe as nuk kanë bere asfarë pagesash , kanë operuar ne menyre ilegale.
- Sipas Ligjit, neni 3, pika 2 ART-i, duhet të koordinonte të gjitha aktivitetet transmetuese me Komisionarin e Përkohshëm për Media. Kjo është një çështje që nuk është arritur të realizohet.

Rekomandim:

- ***ART-ja duhet ti ushtroj te gjitha te drejtat, detyrimet dhe obligimet te cilat dalin nga Ligji nr. 2002/7 PËR TELEKOMUNIKACIONIN***
- ***ART-ja ta mbikëqyre ter territorin e Kosovës, ne fushën telekomunikacionit***
- ***Te gjitha kompanitë te cilat veprojnë ne territorin e Kosovës duhet ti nënshtrohen këtij Ligji***

2. Funksionimi i Bordit te ART-es

Me Ligjit nr. 2002/7 PËR TELEKOMUNIKACIONIN ” është përcaktuar edhe funksionimi i Bordit te ART-ës :

- Në zbatim të nenit 6, pika 7 Bordi duhet të mblidhet të paktën një herë në muaj, gjë e cila nuk është implementuar nga ART. Për një ecuri më të mirë të punës, Bordi i ART ka gjykuar të ngrejë komisionin për licencim, autorizim dhe monitorim. Në këtë komision janë përfshirë tre nga anëtarët e Bordit. Gjithashtu më dt. 12.06.06 Bordi ka miratuar të gjithë dokumentacionin që ka aprovuar komisioni për licencim, autorizim dhe monitorim. Ne sugjerojmë që nga Bordi duhet të miratohen vendimet e komisionit rast pas rasti dhe jo siç përmendëm më lart, që të aprovohet gjithë dokumentacioni njëherësh. Kjo do të ishte e mundur në qoftëse Bordi do kishte zbatuar Ligjin për tu mbledhur të paktën një herë në muaj.

- Nuk ka Statut të miratuar. Nga ART është përcjellë për në zyrën ligjore të UNMIK ne dt. 22.03.2006 draft statuti, por ende nuk është kthyer i firmosur. ART ka përgatitur rregullore të brendshme me të cilat ka mbuluar vakumin e krijuar nga mungesa e statudit .
- Nuk është zbatuar pika 2 e nenit 6 e Ligjit të mësipërm. Aktualisht Bordi funksionon me 4 anëtar. Kuvendi i Kosovës ende nuk ka miratuar anëtarin e peste. Si rrjedhojë e kësaj, Bordi i ART miraton vendimet me 2/3 e 4 anëtareve të emëruar.

Rekomandim:

- *Të bëhet kompletimi i Bordit me 5 anëtar dhe staf profesionist sipas Ligjit.*
- *Mbledhjet e bordit të jene të rregullta siq parasheh Ligji*
- *Te miratohet sa më parë Statuti i ART-ës.*

3. Menaxhimi i të hyrave dhe shpenzimeve financiare

- Sipas nenit 5, pika 2, ART-i është i vetë-financuar, duke mbuluar shpenzimet administrative dhe teknike. Duke qenë se buxheti miratohet nga Kuvendi, praktika e deritanishme ka treguar që nuk është miratuar buxheti i propozuar nga ART dhe nga ana tjetër, buxheti i reduktuar i miratuar nga Kuvendi është bërë pengesë për implementimin e politikave zhvillimore të ART. Nga Kuvendi miratohen pa ndryshim investimet kapitale të propozuara nga ART. Ne mendojmë që investimi në tërheqjen e stafit të kualifikuar është gjithashtu investim kapital. Kufizimet që ART ka në buxhetimin e shpenzimeve të pagave bën të paimteresuar profesionistët e fushës. Kjo nuk është në harmoni edhe me praktikën e aplikuar në rajon.
- Në nenin 5 , pika 4 thuhet që të gjitha fondet e mbledhura nga ART-i, do të depozitohen në një llogari të krijuar enkas për përdorimin e tij në Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës (BPK). Kjo pikë e ligjit, në vitin 2006 nuk është zbatuar pasi ART-i është detyruar nga MEF -i që të gjitha pagesat të kalojnë përmes thesarit sikundër veprojnë agjencionet shpenzuese buxhetore. Kjo ka bërë që ART-i të ketë pengesa procedurale në menaxhimin e fondeve të buxhetuara dhe deri diku të humbë pavarësinë e institucionit të pavarur.
- Nga njëra anë ART-i i nënshtrohet procedurave të thesarit, ndërsa nga ana tjetër nuk financohet nga buxheti, por është vetfinancuese dhe obligohet të zbatoj standardet kosovare të kontabilitetit . Ky trajtim ka bërë që të pamundësohet zbatimi i standardeve të kontabilitetit që kërkohet sipas pikës 4 të nenit 5 të ligjit dhe ART-i të hartoj pasqyrat financiare mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave (cashit).

Rekomandim:

- *Per implementimin e politikave zhvillimore ART-es duhet ti miratohet buxheti i planifikuar nga ART-ja,*
- *Meqe është institucion jo fitim-prurës, ART-ës i mirën te ardhurat e krijuara për te cilat ART nuk ka paraqit projekt te investimeve kapitale apo te shpenzimeve, te gjendet një formë e harmonizimit te kërkesave te ART, të politikave zhvillimore dhe planifikimit dhe miratimit te buxhetit nga Kuvendi i Kosovës.*
- *Llogaria e ART-ës te kaloj ne BQPK , te jete e monitoruar nga MEF dhe BQPK, Këtë llogari ta menaxhoj pa pengesa ART-ja*
- *ART- mos te konsiderohet Agjenci Shpenzuese Buxhetore*
- *Te ruhet pavarësia e institucionit*

4. Raportimi Financiar/ korniza e raportimeve

- ART-ja Pasqyrat Financiare i përgatit sipas UA 2006/14 dhe 2006/15 te MFE
- Por këto korniza nuk prezantojnë te gjitha “SNKSP” apo “INTOSAJ” Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik për sa i takon “Raportimit Financiar mbi Bazat e Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” .
- Në nenin 41, pika 1 thuhet që të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet t’i dorëzojnë ART-it raportet vjetore, duke përfshirë këtu edhe informatat financiare të bazuara në revizionimin e pavarur dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme të Kosovës. Ky nen nuk është zbatuar nga PTK si ofruesi i vetëm për këtë periudhë dhe ART-i është detyruar që këtë informacion ta marrë nga faqet e internetit.

Rekomandim:

- *Nga standardet “ SNKSP”te kalohet ne “SNK”Standardet nderkombetare te kontabilitetit dhe SKK Standardet Kosovare te Kontabilitetit, dhe korniza raportues ta ket bazen Akruale. Ose ne kornizen raportuese te pergaditur nga MEF te kete hapsir edhe per prezantimin kërkesave dhe obligimeve (keshtu kuvendi do ket pasqyre ma te qarte per kërkesat te cilat nuk i ka arketuar ART dhe te cilat priten te arketohen, si dhe ta percjll ne te ardhmen se qfar ka ndodhur me ato kërkesa, dhe te kërkoj llogari per arketime apo mos arketime)*
- *Te gjith ofruesit e shërbimeve ti dorzojne ART-es raportet e audituara vjetore.*

5. Kontabiliteti

- Në nenin 41, pika 1 thuhet që Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet t'i dorëzojnë ART-it raportet vjetore, duke përfshirë këtu edhe informatat financiare të bazuara në revizionimin e pavarur dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme të Kosovës. Ky nen nuk është zbatuar nga PTK si ofruesi i vetëm për këtë periudhë dhe ART-i është detyruar që këtë informacion ta marrë nga faqet e internetit.
- Për periudhën objekt kontrolli, kontabiliteti është mbajtur nga 1 financier, Kontabiliteti mbahet në FRE BALANCE , një sistem i Pagesë-Arketimeve i miratuar nga Thesari, i përshtatur për kontabilitet mbi bazën e keshit. Nga ky sistem nuk ka mundësi të analizohen detyrimet dhe kërkesat. Kështu nga pasqyrat e përgatitura mbi bazën e keshit, si dhe nga korniza raportuese të cilën e ka miratuar MEF dhe Thesari , asnjëherë Kuvendi i Kosovës nuk ka mundësi me dit se sa janë llogarit e arketueshme të ART, e me këtë as nuk mundet me përcjellë realizimin e këtyre llogarive në të ardhmen (pra sa i përket monitorimit të ART-ës nga Kuvendi , ART mundet me ju fal kërkesat e veta ndonjë ofruesi të shërbimeve dhe kuvendi të mos jetë i njoftuar me këtë të dhënë).
- Po ashtu në këtë sistem të FREE Banlance nuk është dhënë mundësia e kontabilizimit të të dhënave të pasurisë së prekshme dhe të asaj të paprekshme
- Ka pas një lëvizje të stafit menaxhues, brenda vitit 2006 janë larguar nga sektori i financave dhe në përgjithësi ka pas lëvizje të stafit menaxhues të ART-ës. Stafit i ri mjaft mi reshte inkorporuar në fushat përkatëse.
- Dega e Financës ka bërë barazimin vjetor me Degën e Thesarit Prishtinë për situacionin e shpenzimeve dhe atë të të hyrave.

Rekomandim:

- *Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet t'i dorëzojnë ART-it raportet vjetore, duke përfshirë këtu edhe informatat financiare të bazuara në revizionimin e pavarur dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme të Kosovës*
- *Te kalohet nga sistemi i kontabilitet sipas bazës së keshit në Kontabilitet me baze aktuale*
- *Te behet kontabilizimi i pasurisë së prekshme dhe asja të pa prekshme*

6. Prokurimi

Në bazë të dëshmimeve të mbledhura dhe të verifikuara në ART, kemi konstatuar se të gjitha rastet e prokurimit të cilat ne i kemi mistruar janë në harmoni me procedurat e prokurimit, janë në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë (Rreg. 2004/03, Ligji 2003/17). Ne gjetëm se prokurimi bëhet përmes njësis qendrore të ART-ës.

Për periudhën objekt kontrolli, në këtë institucion janë zhvilluar 24 procedura prokurimi, “kërkesë për kuotim” me fond limit 83,659.07€ , Në raportin vjetor janë prezantuar 24 lëndë , Raporti vjetor është i nënshkruar nga APP. Nga grupi i punës u kontrolluan 63,12% e shumës totale të lëndëve.

Rekomandim:

- Vlerësimi i ofertave sipas çmimit për njësi nuk ofron dëshmi se është zgjedhur oferta më e lirë, sidomos në rastet kur nuk precizohet pesha e pikave për njësi dhe pjesëmarrja e tyre në total,
- Vlerësimi i ofertave sipas çmimit për njësi ose të eliminohet komplet, ose në këto raste njësitë të merren nga ofertues të ndryshëm (të ndahen artikuj të caktuar nga ofertues ma të lirë), ose të planifikohet totali i sasive të kërkuara për njësi dhe oferta të merret si total e të mos lihet mundësia e manipulimeve të kjo formë e ofertimit.
- Planifikimi - përcaktimi i paramasave (planifikimi, parashikimi, projekcioni i kërkesave) të bëhet me përgjegjësinë më të madhe.

7. Personeli/marrëdhënia e punës

- Numri mesatar i të punësuarve në vitin 2006 ishte 28 punëtorë profilesh të ndryshme,
 - Anëtarët e bordit duhet të kenë kualifikimin superior shkollor dhe njohuri të specializuara për telekomunikacion nga fusha e politikës, frekuencave, interkoneksionit, tarifave, jurisprudencës, ekonomisë, standardizimeve apo të kenësë paku 10 vjetë përvojë punë në sektorin e telekomunikacionit.
1. Në nenin 15, pika 1 thuhet që ART-i do të emërojë inspektorë për të verifikuar ekzekutimin ligjor të kushteve të licencës dhe që të detyrojnë shfrytëzimin ligjor të burimeve të spektrit frekuencor. Në mungesë të buxhetit të aprovuar nga Kuvendi, ART-i nuk e ka zbatuar këtë pikë të ligjit duke

emëruar inspektorë të përhershëm, por ka emëruar inspektorë për raste të veçanta (prej rasti në rast).

2. Jemi skeptikë në se plotësohen kërkesat e ligjit sipas nenit 7, pika 3 dhe nuk kemi mundur të mbërrijmë në përfundimin se vetëm nëpërmjet CV plotësohen kërkesat e kësaj pike pa pasur dokumentacionin përkatës.

Rekomandim:

- *Stafi ka nevojë për trajnim të vazhdueshëm dhe ngritje profesionale, sidomos ata që punojnë apo janë të lidhur me telekomunikacion nga fusha e politikës, frekuencave, interkoneksion, tarifa, jurisprudencës, ekonomi, standardizime Menaxhimin e Financave Publike dhe Prokurimin.*
- *Te kete personel i cili eshte ne gjendje ti analizoj Pasqyrat financiare te ofruesve te shërbimeve te cilat i monitorn ART-ja*
- *ART te emroj inspektor te perhershem te cilet do te verifikojne ekzekutimin ligjor te kushteve te locences*

8. Petty Cash

Për periudhën objekt kontrolli ka pas dhjet rimbushje te pety keshi-it dhe nje terhjekje avans per udhetime zyrtare

- Pety keshi terhiqet nga llogaria ne harmoni me rregullat Thesarit
- Nuk kemi gjetur ndarje te faturave
- Asnjë blerje apo shpenzim nuk kalon limitin e paraparë me rregullore.
- Te gjitha avanset për udhëtime zyrtare janë të mbyllura me kohe
- Ne fund te periudhës te cilën po e auditojm nuk kishte para te gatshme, qe do te thotë se mjete monetare janë në llogari te ART-ës me përfundim të periudhës.
- Arka udhëhiqet sipas kornizës se miratuar nga Thesari
- Te gjitha te hyrat vetjake janë vetëm ne llogari, asgjë nuk inkasohet nga arka.
- Blerjet janë të mbuluara edhe me kërkesa për blerje.

9. Asetet / pasurit

Në Bilancin e Gjendjes nuk tregohen pasuritë dhe detyrimet - sipas Udhëzimit Administrativ 2005/11

ART-ja ka pasur një komision për vlerësimin e pasurive siç parasheh UA 2005/11, por nuk është bërë kontabilizimi i këtyre pasurive.

Ky kontabilizim nuk është bërë në mungesë të instruksioneve të qarta administrative nga MEF si dhe në mungesë të një kornize raportuese gjithëpërfshirëse.

Regjistrimi i pasurive më 31.12.2006 është i përfunduar

Observim :

Regjistrimi i aseteve më 31.12.2006 sipas Udhëzimit Administrativ 2005/11, është bërë fizikisht, po ashtu edhe në vlera. Pasurit në këtë regjistrim kanë numërimi i tyre dhe vendndodhja, nr. i identifikimit, por nuk është bërë një barazim as fizik ndërmjet asaj që është dashur të jetë dhe asaj që është regjistruar.

Ndikimi:

ART-ja është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 2005/11.

Billanci i gjendjes nuk e prezanton drejt pasurinë e entitetit në datën 31.12.2006 (pra as pozicionin e pasurive, kërkesave, si dhe obligimeve dhe kapitalit).

ART në fund të vitit të bëjë barazimin si në vlerë, ashtu edhe në numër apo në njësi të tjera matëse të pasurisë.

Mosbarzimi lë të kuptohet se egziston rreziku që një pasuri të humbet, apo të mos zbulohet humbja e saj, sepse në fund të vitit nuk është bërë barazimi.

Barzimet në vlerë dhe në sasi do të mundësojnë një menaxhim më të besueshëm të pasurisë publike.

Rekomandim:

- Të respektohet në tërësi Udhëzimi Administrativ 2005/11
- Te behet kontabilizimi i kësaj pasurie

Në detyrat e komisionit për regjistrim e pasurisë patjetër duhet të futet si obligative edhe barazimi i gjendjeve aktuale me ato të kontabilitetit, në të vërtetë me atë që duhet të jetë realisht, si dhe të konstatohen diferencat eventuale.

Keto diferencat duhet t'i raportohen Menaxhmentit, i cili do të marrë vendime për to, si dhe me shkrim të njoftohet kontabiliteti për vendimin e mëtejshëm.

Shfrytëzimi i aseteve - Autoparku

Observim:

Nuk disponon një plan për përdorimin e automjeteve të autoparkut të ART-ës, kështu që kërkesat arrijnë prej rasti në rast.

Po ashtu nuk ekziston një normativ i lejuar i shpenzimeve për vetura zyrtare, prandaj ato pranohen si të tilla për aq sa janë paraqitur shpenzime të derivateve, furnizimi me derivate bëhet nga shfrytëzuesi i veturës/ ngasësi në besim, por me autorizim paraprak nga përgjegjësi.

shfrytëzimi i automjeteve bëhet me urdhëresa të shkruara, dihet destinimi, udhëhiqet kilometrazhi, udhëhiqen shpenzimet, udhëhiqen shpenzimet e mirëmbajtjes.

Një përcjellje e tillë, edhe në mungesë të zbatimit të procedurave të kontrollit, faktikisht e pamundëson paraqitjen e rasteve kur automjetet zyrtare shfrytëzohen për nevoja private apo personale.

VIII. Pasqyrat Financiare



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF - GOVERNMENT



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunication Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije

Njësia e Raportimeve

Raportimi i Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006

Tabela 1. Neni 7 – Gjendja e parasë së gatshme

31.12. 2006	Emërtimi	Shën.	Fondi i Përgjithshëm		Fondi i Donator.	Fondi i Mirëbes	Totali (3+4+5+6)
			Të hyrat vetanake	Buxheti			
1	2	3	4	5	6	7	
Pasuria (1a deri në 1d)	1	462,852.62					462,852.62
Paratë në Arkë	1a						
Paratë në Llogaritë Bankare Komerciale	1b						
Paratë në Llogaritë e AQBK-së, Comerzbank, Nënlllogaritë e Comerzbank	1c	462,852.62					462,852.62
Paratë në Transit	1d						
DETYRIMET (2a deri 2d)	2	462,852.62					462,852.62
Fondi për të Hyra Vetanake	2a	462,852.62					462,852.62
Fondi i BKK- së	2b						
Fondi i Depozitave në Mirëbesim	2c						
Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	2d						

Shih Shtojcën 1 – Elementet e Bilancit të Gjendjes së Parave të Gatshme – Definicionet e Përgjithshme. Shuma prej 462,852.62 është alokuar sipas kësaj renditje :

Mjetet e alokuara në vlerë prej 137,920.00 janë mjete të mbetura në fund të vitit 2006 nga të hyrat vetanake.

Mjetet në vlerë prej 312,600.00 janë mjete të zotuar dhe të bartura nga vitit 2006 në vitin 2007, mjete të zotuar për projektin kapital (Projekti i IT) të cilat ende janë në proces, ndërsa mjete 12,825.41 janë mjete që kanë mbetur pa shpenzuar gjatë vitit 2006.

Tabela 2. Neni 8 – Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të organizatave

Nr.	Emërtimi	Alokimet Fondi i Përgjithshëm		Fondi i Donatorëve	Fondi i Privatizimit	Totali
		Të hyrat vetanake	Llogaria e Thesarit granti i qeverisë			
						(3+4+5+6)
1	2	3	4	5	6	7
1	Të Hyrat (1a to 1g)	931,712.00				931,712.00
a	Granti i qeverisë					
b	Të hyrat vetanake	931,712.00				931,712.00
c	Grantet e Përcaktuara					
d	Të Hyrat nga Privatizimi					
2	Shpenzimet (a to f)	468,829.38				468,829.38
a	Kompensimet e të Punësuarve	162,781.72				162,781.72
b	Mallra dhe Shërbime	306,047.67				306,047.67
c	Shpenzimet Komunale					
d	Subvencione dhe Transfere					
e	Shpenzime Kapitale					
f	Shpenzimet e Fondit të Privatizimit					
3	Gjendja e të Hyrave të Pashpenzuara (nr 1- nr 2)	462,852.62				462,852.62
4	Granti i Qeverisë i Pashpenzuar (- nr 3 kol.4)					
5	Totali (Nr. 3 +- 4)	462,852.62				462,852.62

Shih Shtojcën 2 – Elementet e Pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve
 Te hyra gjatë vitit 2006 kanë qene 811,550.00, ndërsa 120,162.00 janë bartura nga viti 2005

Tabela 3. Neni 9 – Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit

	Buxheti i Aprovuar	Alokimet Buxhetore	Shpenzimet	Buxheti i Pashpenzuar	Alokimi i Pashpenzuar
Kompensimi i të Punësuarve	164,354.80	201,322.19	162,781.72	1,573.00	38,540.47
Mallrat dhe Shërbimet	317,300.00	413,840.47	306,047.95	11,252.33	107,792.52
Shpenzime Komunale		3,920.00			3,920.00
Subvencionet dhe Transferet					
Shpenzime Kapitale	312,600.00	312,600.00	-	-	312,600.00
Totali	794,254.80	931,682.66	468,829.39	12,825.41	468,852.27

Tabela 4. Neni 10 – Pasqyra e ndërrimeve të buxhetit

Emërtimi i ndarjeve buxhetore	Rreg 2005/55	Udhëz Admin 2006/10	Udhëz Admin 2006/14
Pagat dhe Rrogat			
Mallrat dhe Shërbimet			
Shpenzimet Komunale			
Subvencionet dhe Transferet			
Shpenzimet Kapitale			
Rezervat			

Shpjegim i tab 3- Buxheti i ART-së sipas ligjit për Telekomunikacion 2002/7, caktohet nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa financimi behet nga mbledhja e të hyrave vetanake, dhe A RT gjatë vitit 2006 nuk ka pasur asnjë ndryshim të Buxhetit.

Tabela 5. Neni 11 – Pasqyra e të hyrave të arkëtuara – organizatat qendrore

Kodi Ekonomik	Emërtimi i të hyrave	Të arkëtuara	Të alokuara	Diferenca
50210	Të hyrat nga licensat	811,250.00	673,600.00	137,650.00
50210	Të hyrat nga Tenderi i IT	300.00	-	300.00
Totali		811,550.00	673,600.00	137,950.00

Tabela 6. Neni 14 – Pasqyra e faturave të papaguara (obligimeve)

*Shuma prej 6,800.00 € dhe 12,420.00 € janë mjete që paguhen nga mbledhja e mjeteve për pjesëmarrje ne tenderin e operatorit të dytë mobil GSM që kanë paguar pjesëmarrësit ne vitin 2007.

Data e Fatures	Numri i faturës	Furnitori	Shuma
01.11-31.11.2006	051004004282/95	PTK Vala 900	68.06
01.11-31.11.2006	051122004363/95	PTK Vala 900	54.06
01.11-31.11.2006	051004004283/95	PTK Vala 900	120.00
01.11-31.11.2006	040311002870/95	PTK Vala 900	257.14
01.11-31.11.2006	051122004364/95	PTK Vala 900	120.00
01.11-31.11.2006	051004004284/95	PTK Vala 900	120.00
01.12-31.12.2006	8	Bife Shtrojera	678.5
01.12-31.12.2006	127110562007	PTK tel fiks	311.99
23.12.2006	919	gazeta express	345
30.12.2006	42683	Aks petrol	572.2
01.12-31.12.06	051004004284/97	ptk vala 900	63.89
01.12-31.12.06	051122004363/97	ptk vala 900	120
01.12-31.12.06	051122004363/97	ptk vala 900	54.06
01.12-31.12.06	051122004364/97	ptk vala 900	120.00
01.12-31.12.06	051004004282/97	ptk vala 900	69.79
01.12-31.12.06	040311002870/97	ptk vala 900	223.61
01.12-31.12.06	051004004283/97	ptk vala 900	120.00
11.10.06	630197	ilir kosova	166.75
16.12.06	C132623	The Economist	6,800.00
31.12.2006	008276	Zeri	460.00
23-24/12/2006	146	Koha Ditore	1150.00
01.12.06	SADI267154	Financial times	12,420.00
04.12.06	0661204/01	DAXA elektronik	279.90
Totali			24,785.95

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit , Prishtinë
Raport i Auditimit të Pasqyrave Financiare, për vitin që përfundon më 31.12.2006

ART si Institucion vet financues dhe jo profitabil paraqet pasqyrat financiare të të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin 2006. Buxheti i ART për vitin 2006 i ndarë nga Kuvendi i Kosovës është 794,254.80 € ,dhe atë sipas këtyre kategorive:

Paga dhe Mëditje : 164,354.80 €

Mallra dhe Shërbime:317,300.00 €

Investime Kapitale:312,600.00 €

Te hyrat vetnanke te bartura nga viti 2005 ne vitin 2006 janë 120,162.00

Ndërsa Totali i të hyrave gjatë vitit 2006 është:811,550.00 €

Shuma e alokuar gjate vitit 2006 për mbulimin e shpenzimeve të ART-së është: 793,762.00

€.Paga dhe mëditje; 164,322.10 €

Mallra dhe shërbime;316,840.40 €

Investime Kapitale:312,600.00 €

Mbetja (Teprica) e vlerës së mjete prej 137,920.00 € nga të hyrat e mbledhura gjatë vitit 2006 janë alokuar ne dhjetor 2006 për tu bartur si alokime në vitin 2007.

Vlera prej 30 euro nuk janë alokuar (bartur) për shkak të një gabimi teknik qe ka ndodhur gjatë regjistrimit të të hyrave.

Totali i shpenzimeve gjate vitit 2006 kap shumën 468,829.38 € e ndarë sipas kategorive

Paga dhe Mëditje : 162,781.72 €

Mallra dhe shërbime:306,047.65 €

Ne Kategorinë Mallra dhe Shërbime janë të përfshira edhe shpenzimet komunale.

Ndërsa alokimet për Investime Kapitale nuk janë shpenzuar gjate vitit 2006 dhe komplet shuma prej 312,600.00 € janë bartur si alokim në vitin 2007.

Data: 08.02.2007

XIII. SHËNIME SQARUESE

1. SHËNIME SQARUESE

Në bazë të Ligjit 2002/7 Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART), themelohet si autoritet i pa varur ,jo profitabil brenda IPVQ-ve,dhe mban përgjegjësi për implementimin e politikave të IPVQ-ve dhe Ministrisë,të udhëhequra nga ky ligj. Selia e ART-së gjendet ne Lagjen Pejton, Rruga Pashko Vasa, nr. 12 Prishtinë.

2. PERIUDHA RAPORTUESE

Periudha raportuese nënkupton një periudhë dymbëdhjet mujore prej 01.janarit e deri 31.dhjetor të vitit 2006.

3. BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime të raportimit në Kuvendin e Kosovës për aktivitetet e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit në pajtim me kërkesat financiare dhe raportuese të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP); Raportimit financiar sipas Bazës së Kontabilitetit të Keshit”, si dhe janë në harmoni me kornizën e miratuar nga MEF-Udhëzimi Administrativ 2006/14 mbi përmbajtjen e Pasqyrave Financiare të Organizatave Buxhetore.

Pasqyrat financiare janë prezantuar në EURO ,valuta funksionale brenda territorit të Kosovës

Përgjegjësia për Pasqyrat financiare
Kjo përgjegjësi bie mbi Shefin e Financave

4.Fondet, buxheti,revizioni dhe raportimi

Buxheti i ART për vitin 2006 i ndarë nga Kuvendi i Kosovës është 794,254.80 € ,dhe atë sipas këtyre kategorive:

Paga dhe Mëditje : **164,354.80 €**

Mallra dhe Shërbime: **317,300.00 €**

Investime Kapitale: **312,600.00 €**

Te hyrat vetjake te bartura nga viti 2005 ne vitin 2006 janë 120,162.00

Ndërsa Totali i të hyrave gjatë vitit 2006 është:811,550.00 €

Shuma e alokuar gjate vitit 2006 për mbulimin e shpenzimeve të ART-së është:
793,762.00 €.

Paga dhe mëditje; **164,322.10 €**

Mallra dhe shërbime; **316,840.40 €**

Investime Kapitale: **312,600.00 €**

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit , Prishtinë
Raport i Auditimit të Pasqyrave Financiare, për vitin që përfundon më 31.12.2006

Përmbajtja	Buxheti i miratuar	Alokimet buxhetore	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar
Total	794,254.80	793,762.00	468,829.38	325,425.54	324,932.62

<i>Kategoritë Ekonomike</i>	<i>Alokimet Financiare</i>		<i>Totali i Alokuar</i>
	Fondi burimor 21	Fondi burimor 22	
Paga dhe mëditje	136,000.00 €	28,322.19 €	164,322.10 €
Mallra dhe shërbime	225,000.00€	91,840.47 €	316,840.40 €
Shpenzime Kapitale	312,600.00 €	-	312,600.00€
Totali	673,600.00 €	120,162.60 €	793,762.60 €

* Shuma prej 120,162.60 janë mjete të bartura nga viti 2005

Raporti i ekzekutimit të buxhetit për Vitin 2006

<i>Kategoritë Ekonomike</i>	<i>Të Aprovuara</i>	<i>Të Alokua</i>	<i>Të shpenzuara</i>	<i>Të Mbetura nga alokimi</i>
Paga dhe mëditje	164,354.80 €	164,322.10 €	162,781.72 €	1,540.00 €
Mallra dhe shërbime	317,300.00€	316,840.40 €	306,047.67 €	10,793.28 €
Shpenzime Kapitale	312,600.00 €	312,600.00 €	-	312,600.00
Totali	794,254.80 €	793,762.60 €	468,829.39 €	324,933.28 €

5. SHPENZIMET

4.1. Paga dhe Mëditje

Në bazë të Ligjit për Telekomunikacion 2002/7, neni 6, alinea 3, anëtarët e Bordit të ART-së do të paguhet në pajtim me skemen aplikative të pagave për anëtarët e Kuvendit, e cila do të pasqyrohet në buxhetin fillestar të ART-së dhe do të prezantohet Kuvendit për miratim, ndërsa stafi administrativ paguhet sipas vendimit të Bordit 086/06.

4.2. Mallra dhe Shërbime:

Të gjitha shpenzimet në këtë kategori janë nënshtruara procedurave mbi ligjin e Prokurimit Publik dhe ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe rregullores së Thesarit -02 shpenzimi i parave publike.

6. PAGESAT OPERUESE NGA ENTITET E TJERA FINANCIARE

ART nuk ka marr asnjë donacion apo pagës nga ndonjë institucion tjetër.

7. ARKËTIMET

Veprimtaria e ART-së do të financohet nga paratë të cilat do të mblidhen përmes aplikimit transparent të tarifave rregullative në pajtim me ligjin e Telekomunikacionit 2002/7, duke përfshirë por mos u kufizuar vetëm në :

- Autorizimet,
- Liçensimet,
- Dhënja e numrave dhe
- Akordimin e të drejtës për përdorim të spektrit frekuencor .

8. PARATË E GATSHME DHE EKUIVALENTET E PARASË

Mjete në para të disponueshme, janë të shprehura ato mjete reale të disponueshme në momentin e dredhjes dhe Llogarinë e ART-së në BPK.

9. TE HYRAT VETANAKE TË ART-së

ART ka përgatitur Pasqyrën e të hyrave për vitin 2006, që ka një vlerë prej 811,550.00 si të hyra vetanake.

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit , Prishtinë
Raport i Auditimit të Pasqyrave Financiare, për vitin që përfundon më 31.12.2006

Data e pagesës	Emri i operatorit	shuma
23/03/06	Pagesa e pjesërishme për- LICENCIM N.P.KUJTESA	80,000.00€
13/04/06	Prej IPKOS 12/04/06	75,000.00 €
28/04/06	Pagës nga PTK DT:30/12/05-PCB	150,000.00 €
11/05/06	Pagesa per licence COMPANY IPKO.NET.LLC	12,500.00 €
15/06/06	Pagesa per licence COMPANY IPKO.NET.LLC	12,500.00 €
03/07/06	Transfer nga AURORA ISRAPHONE për LICENCE PER ART	18,750.00 €
08.08.06	Pagës për licenc nga Ipko net	12,500.00 €
15.08.06	Pagës për licencë nga Ipko net	12,500 .00 €
16.08.06	Pagës për licencë nga Ipko net	25,000 .00 €
12.09.06	Pagesa per licenc nga Ipko Net Telefoni Fikse	87,500.00 €
12.10.06	Pagesë për Licencë nga N.P. Kujtesa	70,000.00 €
20.11.06	Pagës për tender IT	30.00 €
21.11.06	Pagës për tender e IT dhe Pagës nga PTK për tarifë vjetore	250,060.00 €
23.11-01.12.06	Te hyrat nga tenderi i IT	210.00 €
21.12.06	Te hyra nga licenca TVN Kabelnet	5,000.00 €
Gjithsej		811,550.00 €

10. LLOGARIT E ARKETUESHME

Me 31.12.2006 gjendja e llogarive të arketueshme kapin vlerën prej 434,468.00€

Emri i Operatorit	Lloj i Shërbimit	Borxhi i pa paguar
PTK	1% e të hyrave e vitit 2005 nga telefonia Fixe dhe Mobile	415,718.00 €
Israphone	Licensa për shërbime telekomunikuse ndërkombëtare	17,500.00 €
Israphone	licenca e shërbimeve me vlerë te shtuar	1,250.00 €
Totali		434,468.00 €

11. LLOGARIT E PAGUESHME

Llogarit e pagueshme janë 24,785.95€

Këto fatura nuk janë paguar për arsye të vonesës së faturave:

Për shënime ma detale referoju Tab. Nr. 6 të Pasqyrat Financiare

Faturat The Economist ne shumë prej 6,800.00 si dhe fatura e The Financial Times ne shume prej 12,420.00 duhet të paguhen nga të hyrat e krijuara për pjesëmarrje ne tenderin e dytë Mobil .

12.DETYRIMET KONTIGJENTE- Menaxhmenti nuk ka njohuri për ekzistimin e detyrimeve te tilla.

13.NGJARJA PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk janë evidentuar raste të rëndësishme që kanë ndikim domethënës në pasqyrën e bilancit.

14.PARIMI I VAZHDIMËSISË

Mundësia e vazhdimit të aktivitetit të subjektit edhe për 12 (dymbëdhjetë) muajt e ardhshëm, në bazë të mjeteve të disponueshme, projekteve aktive dhe planeve të menaxhmentit të përgjithshëm, nuk vihet në dyshim.

15.PASURIA E PREKSHME DHE E PAPERKSHME

Në Kornizën Raportuese të përgatitur nga Departamenti i Thesarit nuk ka pasur pozicion (vend) për të paraqitur në Aktive asnjë grup a klasë të pasurive të prekshme apo të paprekshme, apo Obligimeve në Pasivë.

16.Pajisjet dhe makineritë: Zërat që përfshihen në këtë kategori paraqesin pajisjet e ART-së dhe njihen si pasuri kur ka gjasa që ; Benifitet/përfitimet ekonomike në të ardhmen do të rrjedhin në entitet. Kostoja e mjetit duhet të matet me besueshmëri. Ato fillimisht janë të regjistruara sipas kostos. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që janë te nevojshme për ta sjellë ne gjendje për përdorimin e paraparë. ART i mban pasuritë sipas koston blerëse dhe ende nuk ka filluar llogaritja e zhvlerësimit .

Shkallët e zhvlerësimit janë:

Ndërtesat	5 %
Pajisjet e rënda	15 %.
Pajisjet	20 %

Emri i Pajisjes	Statusi	Çmimi
Automjete	Përdorim	191,833.56
Server	Përdorim	4,605.00
Llaptop	Përdorim	15,285.00
Printerë& Fotokopje	Përdorim	14,068.00
Telefona	Përdorim	8,400.00
Klima	Përdorim	3,960.00
Mobile	Përdorim	18,232.67
Kompjuter	Përdorim	32,874.78
GIS Licenca	Përdorim	16,480.00
Gjithsej		305,739.00€

XIV. Lista e dokumentacionit të konsultuar dhe të audituar

- Bilanci i gjendjes për periudhën financiare deri më 31.12.2006
- Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve prej 01.01 deri 31.12.2006
- Pasqyrat e tjera financiare për vitin 2006
- Pasqyra e të gjitha saldove të librave kryesorë të vitit 2006
- Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike
- Urdhëresa Administrative 2005/15
- Urdhëresa Administrative 2005/11
- Urdhëresa Administrative 2006/14
- Urdhëresa Administrative 2006/15
- Mostra të Faturave të shitjes/shërbimeve/qeras
- Mostra te licencave
- Regjistrimi i Mjeteve Themelore/pajisjes/inventarit më 31.12.2006
- Raporti nga Thesari më 31.12.2006
- Ligji mbi Telekomunikacionin
- Rregullore te ART-ës
- Proqese nga mbledhjet e Bordit
- Proqese nga komisionet e ART-es
- Të gjitha rregulloret e brendshme
- Buxheti i Planifikuar
- Legjislacioni nacional, në mënyrë të veçantë ligjet që i takojnë fushës financiare
- Mandati aktual dhe termat e referimit për auditim

XV. Kontaktimi me zyrtarët përgjegjës gjatë procesit të Auditimit

<u>Emri i zyrtarit</u>	<u>pozicioni</u>
1. Anton Berisha	Kryetar i Bordit te ART-es
2. Mark Buzhala	UD Shef i Administratës
3. Fatmir Gervalla	UD Shef i Financave
4. Petrit Derguti	UD Shef i zyres ligjore
5. Arian Qorolli	Zyrtar i Prokurimit

XVI. Sqarime të shkurtesave të përdorura :

5. **SKK**-Standardet Kosovare të Kontabilitetit
6. **SNA**-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
7. **SNK**-Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
8. **SNKSP**- Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
9. **MEF**-Ministria e Ekonomisë dhe Financave
10. **PSSP**- Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral të KB-ve në Kosovë
11. **UA**-Urdhëresa Administrative
12. **KK**-Kuvendi Komunal
13. **BPK**-Banka e Pagesave të Kosovës
14. **BKK**-Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
15. **AQF**-Autoriteti Qendror Fiskal
16. **UNMIK**-Misioni Civil i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
17. **SHPK** - Shërbimi Policor i Kosovës